

# NEWSLETTER

## Janar

**Analiza Vjetore  
e Albsig sh.a.**

**Shëndetin, Automjetet  
dhe Pronën Shqiptarët  
ia Besojnë Vetëm Albsig**



**Albsig Vlerësohet nga  
Unioni Turistik Shqiptar  
si “Shoqëria më  
e Mirë e Sigurimeve  
për Vitin 2022”**

**Albsig  
Paguan në Kohë  
Rekord të Gjitha  
Llojet e Dëmeve**

**BLI ONLINE  
Sigurimin e Banesës,  
Fito Albsig Med Falas**

**Llogarit Pensionin Online  
në Vetëm 3 Hapa**

**Kushtet e  
Pensioneve Shtetërore  
për Vitin 2023 dhe  
si do të Bëhet Llogaritja  
për të Punësuarit?**

Shoqëria e Sigurimit Albsig sh.a., pjesë e Grupit KASTRATI, ushtron aktivitet të suksesshëm që nga viti 2004, në cilësinë e siguruesit të Jo - Jetës. Me një rrjet me 28 degë, Albsig mbulon territorin e Republikës së Shqipërisë. Albsig mbështetet në stafin e dedikuar dhe profesional dhe ofron shërbim të shpejtë dhe cilësor.

#### **VIZIONI**

Klienti, prioriteti ynë. Ne tejkalojmë pritshmëritë e tij përmes shërbimit, integritetit dhe profesionalizmit.

#### **MISIONI**

Të jemi zgjedhja e parë e çdo klienti. Ne rritemi bashkë me klientët tanë.

#### **FILOZOFIA**

Besim dhe solidaritet me klientët për të arritur suksesin e përbashkët.



# Partneri juaj i sigurtë!

---



PJESË E  KASTRATI GROUP





## Analiza Vjetore e Albsig sh.a.

Analiza e punës është një proces tashmë i bërë traditë në Albsig, pasi ky i fundit u mundëson menaxherëve që nëpërmjet informacioneve, analizave dhe njohurive që disponojnë, të krijojnë vende të reja pune, të përcaktojnë numrin e nevojshëm të njerëzve për plotësimin e tyre, si dhe të përcaktojnë njohuritë e nevojshme për rritjen, zhvillimin dhe konsolidimin e Shoqërisë, e cila aktualisht është lider në treg për produkte vullnetare.

**“Viti 2022 do të mbetet për Albsig si viti me stabilitet më të arritshëm dhe më i suksesshëm në të gjitha fushat. Në sajë të punës së mirë planifikuese, organizuese e drejtuese, u bë e mundur që gjatë këtij viti rezultatet në shumë fusha të kenë një rritje nga më të mirat. Në sajë të masave organizative dhe efektive, Albsig vlerësohet si Shoqëria me trendin më të lartë të rritjes për 3-vitet e fundit”,**

–tha në fjalën e hapjes së analizës vjetore z. Muharrem Bardhoci, Drejtori i Përgjithshëm i Albsig. Sipas të dhënave të publikuara nga analiza 1-vjetore e Albsig, veprimtaria gjatë 2022 u përqëndrua në zbatimin e prioriteteve dhe objektivave të vendosura nga drejtuesit e Shoqërisë të mbështetur nga presidenti i Kastrati Group si pjesë e fuqishme e këtij grupi biznesi, si dhe në plotësimin e detyrimeve të përcaktuara në aktet ligjore, nënligjore, rregullore dhe aktet e brendshme dhe të Albsig. Në analizën vjetore të Albsig marrin pjesë të gjithë punonjësit e Albsig, duke përfshirë këtu dhe drejtuesit e degëve nëpër rrethe pasi këta të fundit janë dhe hallka kryesore e zinxhirit të shitjeve të kompanisë. Analiza e punës vjetore të Albsig u mbyll me sukses për t’u pasuar në takimin e radhës.

# Albsig Vlerësohet nga Unioni Turistik Shqiptar si “Shoqëria më e Mirë e Sigurimeve për Vitin 2022”

Albsig vlerësohet nga Unioni Turistik Shqiptar si “Shoqëria më e mirë e sigurimeve për vitin 2022” me motivacion: “Dalluar për profesionalizmin dhe cilësinë e lartë të shërbimeve dhe kontributin e dhënë në mbështetjen e veçantë ndaj bizneseve që operojnë në sektorin e udhëtimeve dhe turizmit në Shqipëri.”

Faleminderit Unionit Turistik Shqiptar për këtë vlerësim! Albsig sh.a. cilësohet si Shoqëria me rritjen më të madhe në industrinë e sigurimeve për të tretin vit radhazi dhe me ritmet më të larta të pagesave të dëmeve.

Albsig gjatë vitit 2022, vazhdoi traditën e motivimit të punonjësve nëpërmjet trajnimeve efikase duke i gërrshetuar me ture turistike në Shqipëri, me qëllim jo vetëm argëtimin, por gjithashtu njohjen me vlerat historike & kulturore vendase.

Për vitin 2023 Albsig synon rritjen e aktivitetit të Shoqërisë përmes trajnimeve dhe kualifikimeve të vazhdueshme të burimeve njerëzore.





**Bli Online Sigurimin e Banesës  
& Fito Albsig Med Falas**

Albsig nuk ndalet me surprizat, me të cilat përpiqet të shpërblejë sa më shumë klientë besnikë në çdo periudhë të vitit. Kësaj radhe, përmes platformës "Bli Online" Albsig është munduar që t'ju vijë në ndihmë klientëve të saj dhe jo vetëm, për të bërë të mundur sigurimin e pronës përmes rrugëve online. Sigurimi nga zjarri është "mburoja" e sigurimit të pasurisë që mbulon dëmet dhe humbjet e shkaktuara nga zjarri dhe rreziqet shtesë. Në kuadër të sensibilizimit të konsumatorëve, Albsig ka favorizuar këto të fundit me bonuse, zbritje dhe oferta për produkte dhe paketa të ndryshme. Ndryshe nga vitet e tjera fokusi i Albsig është tregu "online". Janë targetizuar grupet e konsumatorëve, të cilët përmes online-it janë sinjalizuar për përfitimet.

## **"Bli Online dhe përfito 30% ulje për Sigurimin e Pronës"**

dhe fito Albsig Med Falas, është kjo thirrja që po ju bën konsumatorëve përmes kanaleve online Shoqëria e Sigurimeve Albsig. Për të përfituar zbritjet e deklaruar mjafton të jesh ndjekës i Albsig në faqet e Facebook dhe Instagram. Njëkohësisht, mund të bësh menjëherë porosinë për produktet që të nevojiten duke përfshirë këtu dhe sigurimin e pronës. Platforma "Bli Online" është një ndër platformat më të mirëorganizuara dhe në favor të klientit. Albsig i këshillon të gjithë klientët të vazhdojnë të bëjnë blerjet e tyre të përditshme në platformën "Bli Online" në web-in e Shoqërisë, pasi Albsig ju dhuron cilësi, kursim dhe përfitim në të njëjtën kohë.



## **Jeto i qetë, siguro shtëpinë me ALBSIG.**

Shmang çdo risk financiar duke siguruar shtëpinë nga rreziqet:

- Zjarr
- Rrufe
- Eksplozion
- Tërmet
- Rrjedhje të tubacioneve të ujrave utilitare, etj.
- Përgjegjësi ndaj palëve të treta (dëmtime në pronën e fqinjëve) me limit dëmshpërblimi deri në €10,000.



## LLOGARIT PENSIONIN ONLINE NË VETËM 3 HAPA

Albsig ju mundëson klientëve cilësi, kursim dhe përfitim kohe. Mjafton të bëhesh pjesë e Albsig Invest, duke e vizituar atë në faqen zyrtare. Për të gjithë të interesuarit për fondin e pensionit privat, Albsig ju vjen në ndihmë në çdo mundësi duke përfshirë dhe atë online. Për të gjithë klientët e Albsig dhe jo vetëm, ata që tashmë kanë projektuar të ardhmen e tyre edhe në pleqëri, për të pasur një jetë të qetë dhe pa probleme duhet të investojnë në kohë për të ardhmen. Një ndër investimet më të rëndësishme është përfshirja në pensionin privat.

Për të llogaritur pensionin:

- 1.** Vizito faqen e [www.albsiginvest.al](http://www.albsiginvest.al)
- 2.** Shko në menunë kryesore dhe zgjidh Fondet e Pensioneve
- 3.** Zgjidh Llogaritësi i Pensionit

Përmes këtyre tre hapave të thjeshtë ju mund të nisni investimet tuaja për një të ardhme të sigurt për vete dhe familjen tuaj. Vizitoni faqen e [www.albsiginvest.al](http://www.albsiginvest.al) dhe do të informoheni rreth Fondit të Pensionit Albsig, Fondit të Pensionit "Smart Pension", gjithashtu dhe Fondin e Investimit "Albsig Standard". Për t'u adresuar në këto fonde mjafton të shkruani në e-mailin [info@albsiginvest.al](mailto:info@albsiginvest.al) ose të telefononi në numrin +355696099922.

# SHËNDETIN, AUTOMJETET DHE PRONËN SHQIPTARËT JA BESOJNË VETËM ALBSIG

Shqiptarët sa vjen dhe vlerësojnë më shumë jo vetëm produktet dhe shërbimet e Albsig, por edhe qasjen e Shoqërisë në tërësi në tregun e sigurimeve. Sipas të dhënave statistikore të AMF-së për vitin 2022, tregu i sigurimeve shënoi një rritje prej 9.16% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Edhe pse peshën më të madhe të tregut të sigurimeve e zënë sigurimet e detyrueshme me 62.16%, ndërsa sigurimet vullnetare zënë 37.84% të primeve të shkruara bruto, Albsig sërish kryeson tregun për produktet vullnetare. Përsa i përket Albsig, konkretisht për muajt Janar-Dhjetor 2022, ka raportin më të lartë të Sigurimeve Vullnetare 50.06%. Jo vetëm kaq por Albsig është lider në dëmshpërblim. Edhe për këtë vit është Shoqëria që ka numrin më të vogël të dëmeve pezull (të papaguara) në tregun e sigurimeve. Kjo gjë reflektohet fare qartë në buletinin e të dhënave të AMF.

Konkretisht përsa i përket numrit të dëmeve pezull, Albsig ka një ulje në 219 dëme nga 264 dëme që kishte në të njëjtën periudhë të një viti më parë.



## 01

**Tregu  
i Sigurimeve**

Rritje me  
9.16%



## 01

**Sigurimet  
Vullnetare**

50.06%  
e tregut



## 01

**Numri Më  
i Vogël për  
Dëmet Pezull**

219 dëme  
për 2022



# Çfarë Evidenton që Albsig Pagan në Kohë Rekord të Gjitha Llojet e Dëmeve

Kjo është dhe një prej arsyeve kryesore pse klientët zgjedhin Shoqërinë Albsig për t'u siguruar. Albsig vazhdon të renditet i pari në këto grupe produktesh të rëndësishme për konsumatorët e tij. Për më shumë se 5 vite kryeson tregun si lider në dëmshpërblime.

Për periudhën Janar-Dhjetor 2022, 50.06% ka raportin më të lartë në treg për Sigurimet Vullnetare, e dhënë kjo që sa vjen e forcohet. Po në këtë periudhë Janar-Dhjetor 2022, zë 34.70% të tregut Sigurimi KASKO dhe kryeson tregun në këtë sigurim.

Në po këtë periudhë Janar-Dhjetor 2022, zë 41% të tregut Sigurimi Përgjegjësitë Civile, duke u pasuar me 53.51% të tregut Përgjegjësia e Ndërtuesit dhe 43.40% të tregut Sigurimi i Garancive.

**50.06**  
%

Raporti në Treg për  
Sigurimin Vullnetar

**34.70**  
%

Përqindja në Treg për  
Sigurimin Kasko

**41**  
%

Përqindja në Treg  
për Sigurimi i  
Përgjegjësië Civile

**53.51**  
%

Përqindja në Treg  
për Përgjegjësinë  
e Ndërtuesit

**43.40**  
%

Përqindja në Treg për  
Sigurimi i Garancive

 **ALBSIG**

PJESË E  KASTRATI GROUP



# KUSHTET E PENSIONEVE SHETËRORE PËR VITIN 2023 DHE SI DO TË BËHET LLOGARITJA PËR TË PUNËSUARIT?



Edhe për vitin 2023 do të ndryshojë skema e pensioneve në vend. Sikundër ka ndodhur çdo vit tjetër që prej reformimit të skemës së pensioneve në 2014-ën, moshë e dalje në pension për gratë është rritur me 2 muaj të tjerë, ndërsa portofolit të sigurimeve i shtohen edhe 4 muaj të tjerë. Ndërkaq, prej fillimit të muajit të gjithë ata që mbushin moshën e dalje në pension këtë vit dhe që duan të përfitojnë pension të plotë pleqërie, do të duhet të kenë 38 vite periudhë kontributesh nga 37 vite e 8 muaj që ishte një vit më parë.

Në një intervistë në emisionin e mëngjesit në një nga televizionet kombëtare, ekspertja e sigurimeve shoqërore Afroviti Dhuci, shpjegoi më tepër rreth kushteve të pensioneve për këtë vit ndërsa iu përgjigj edhe shqetësimeve të qytetarëve përmes telefonatave në studio. Ajo sqaroi me detaje, si për gratë edhe burrat e kësaj moshe, ndryshimet që kanë ndodhur me rritjen e moshës. Konkretisht, sipas ekspertës këtë vit kushtet e pensioneve kanë ndryshuar duke u rritur dy muaj për çdo vit për përfitueset gra: "Sigurisht, ndryshimet parametrike që iu bënë skemës së pensioneve në vitin 2014 konsistonin në rritjen e moshës dhe viteve të punës për personat që kanë qenë të siguruar dhe të punësuar. Aktualisht kushtet në vitin 2023 kanë ndryshuar duke u rritur dy muaj për çdo vit për përfitueset gra, dhe këtë vit dalin në pension të gjitha përfitueset gra të cilat kanë qenë të siguruara gjatë jetës së tyre dhe kanë lindur në harkun kohor 1 shtator 1961 deri në 30 qershor të vitit 1962. Pra të gjitha gratë që kanë lindur në këtë hark kohor dalin në pension në vitin 2023 në moshën 61 vjeç e 6 muaj. Periudha e përgjithshme e sigurimit për të përfituar një pension të plotë nga skema e sigurimeve shoqërore është 38 vite punë për të marrë një pension të plotë.

Edhe për ato përfituese gra të cilat nuk e kanë plotësuar periudhën e përgjithshme të sigurimit është e mjaftueshme 15 vite punë për t'u futur në skenë për të përfituar një pension nga skema e sigurimeve shoqërore. Pra, kufiri minimal për të marrë një pension kur plotësojnë moshën është 15 vite", - tha ekspertja. Po ashtu edhe për përfituesit burra, moshë e pensionit do të jetë mbi 38 vite punë. "Ndërsa për përfituesit burra, dalin në pension të gjithë ata burra që kanë lindur në harkun kohor 1 janar të vitit 1958 deri në 31 dhjetor 1958, pra në moshën 65 vjeç."

Periudha e përgjithshme e sigurimit edhe për përfituesit burra është 38 vite. Për ata persona të cilët kanë punuar mbi këto vite dhe mbi moshën e pensionit sigurisht që mund të ketë një shtesë mbi pensionin e pleqërisë", - tha ajo më tej. "Është një nen i veçantë mbi shtesën e viteve për të gjithë ata persona të cilët kanë realizuar 38 vite punë në 2023, kanë punuar përtej moshës 65 vjeç ose 61 vjeç e 6 muaj pasi kanë plotësuar moshën për pension pleqërie dhe kanë plotësuar periudhën që i kërkohet në nenin 92 të ligjit për 38 vite që është aktualisht, do të marrin një shtesë për aq muaj sa vazhdojnë dhe kontribuojnë në skemën e sigurimeve shoqërore mbi bazë të kontributeve të derdhura, për aq muaj", - shpjegoi ekspertja.

## Pensionet Private në Fokus të Qeverisë Shqiptare

Qeveria parashikon që të miratojë një ligj të ri për fondet e pensioneve private duke sjellë një seri ndryshimesh për një treg që ende mbetet joproduktiv në vend. Nga statistikatat e marra vërehet se vetëm një numër i vogël qytetarësh derdhin kontribute vullnetare për të përfutur një pension privat shtesë. Mungesa e kulturës në sigurime, shoqëruar me nivelin e ulët ekonomik ka bërë që kontributi për moshën e pensioneve të shihet si e papërbalueshme nga vetë qytetarët.

Argumenti bazë se pse po bëhen këto ndryshime lidhet me nxitjen dhe zgjerimin e këtij tregu por edhe me qartësimin e disa aspekteve që lidhen me menaxhimin e fondeve. Projektligji është përgatitur nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF).

### Përfitimet e Projektligjit

AMF propozon rritjen e përjashtimit nga taksat, si për kontributet e punëmarrësve, ashtu edhe për ato të punëdhënësve, ndërsa kërkon që pensionet të mos taten në përfitim për pjesën e kontributeve, por vetëm për kthimin nga investimi. Për të nxitur investimet e punëmarrësve (por edhe të punëdhënësve të tyre) në fonde të pensioneve private, ligji aktual parashikon incentiva fiskale në formën e përjashtimit të kontributeve nga tatimi mbi të ardhurat personale. Kontributi i bërë nga çdo anëtar i një fondi pensioni, zbritet nga të ardhurat personale të tij për efekt tatimi, pra përpara se të llogaritet tatimi mbi të ardhurat. Kufiri maksimal për lehtësitë tatimore për kontributet vjetore, është vlera më e vogël që del nga krahasimi i shumës 200 mijë lekë dhe 15% të të ardhurave vjetore bruto të anëtarit. Në rast se anëtari është mbi 50 vjeç, kufiri maksimal për lehtësitë tatimore për kontributet vjetore është vlera më e vogël që del nga krahasimi i shumës 250 mijë lekë dhe 25% të të ardhurave vjetore bruto të anëtarit. Sipas projektligjit të propozuar nga AMF, kufiri maksimal mujor, për lehtësitë tatimore, do të jetë deri në nivelin e pagës minimale të miratuar në shkallë vendi. Konkretisht, sot përjashtimi nga tatimi do të shtrihej deri në një shumë kontributesh prej 30 mijë lekësh në muaj. Sipas burimeve nga tregu, kjo formulë është propozuar nga drejtuesit e shoqërive administruese dhe është pranuar nga AMF.



## Lehtësitë Tatimore

Nëse propozimi i AMF miratohet, shuma e kontributeve të përjashtuar nga tatimet do të arrijë në 360 mijë lekë në vit, ose 80% më shumë krahasuar me pragun aktual prej 200 mijë lekësh (për personat mbi 50 vjeç përjashtimi shkon në 44% më shumë krahasuar me kufirin aktual). Sipas ligjit aktual, kontributet e bëra nga punëdhënësi dhe çdo kontribues tjetër, në emër dhe për llogari të anëtarit të një fondi pensioni, për efekte fiskale, nuk vlerësohen si të ardhura personale të anëtarit. Kontributet e bëra nga punëdhënësi në interes të punëmarrësve të tij në një plan pensioni profesional vlerësohen shpenzim operativ, deri në shumën vjetore për çdo punëmarrës, të barabartë me 250 mijë lekë dhe kjo shumë vlerësohet shpenzim i zbritshëm, për qëllime të tatimit mbi fitimin të punëdhënësit. Projektligji i ri propozon që, edhe për kontributet e punëdhënësit, vlera e njohur si shpenzim i zbritshëm për qëllime të tatimit mbi fitimin të bazohet në pagën minimale. Me vlerën në fuqi të pagës minimale, përjashtimi nga tatimi për kontributet e punëdhënësit do të arrijë në 360 mijë lekë në vit ose 44% më shumë krahasuar me nivelin maksimal që njeh ligji aktual. Duke mbledhur kontributet e punëdhënësit dhe ato të punëmarrësit, projektligji parashikon një përjashtim tatimor mbi kontributet e një individi, sa dy paga minimale, shumë që aktualisht përkthehet në 60 mijë lekë në muaj, ose 720 mijë lekë në vit. Kthimi i investimit, përfshirë fitimet nga kapitali prej investimeve të kryera me asetet e fondit të pensionit nuk i nënshtrohen tatimit, as për vetë fondin e pensionit dhe as për shoqërinë administruuese. Ky përjashtim ruhet edhe në projektligjin e ri.





☎ +355 (0) 42254770 / 764

✉ [info@albsig.al](mailto:info@albsig.al)

---

[WWW.ALBSIG.AL](http://WWW.ALBSIG.AL)